



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 24.05.2023

Nr: 140

Ora: 16:35

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE ANKIMORE NR. 63, DATË 22.05.2023 DHE NR. 70, DATË  
22.05.2023**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 24.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES NR. 1:** Subjekti zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, përfaqësuar nga kryetari z. Zef Bushati dhe nga z. Petrit Dedaj, me deklaram.

**ANKUES NR.2:** Subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”, përfaqësuar nga z. Fabian Topollari

- OBJEKT:**
1. Kundërshtimi i vendimit nr. 260, datë 16.05.2023 i KZAZ nr. 07 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e këshillit bashkiak, bashkia Pukë”.
  3. Ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës së Administrimit Zgjedhor bashkia Pukë, sipas rezultatit të rinumërimit dhe rivlerësimit të votave.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 123/1 dhe pika 2 e nenit 124 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **Rrethanat e çështjes:**

1. Në datën 14.05.2023, në 61 bashki në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse kanë plotësuar dhe miratuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për kryetarët e bashkive dhe për këshillat bashkiakë. KZAZ nr. 7, bashkia Pukë ka miratuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për këshillin e bashkisë me vendimin nr. 260, më datë 16.05.2023, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e këshillit bashkiak, bashkia Pukë”.
2. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur kërkesë ankimore subjektet zgjedhore “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Petrit Dedaj dhe “Aleanca Progresiste LZHK”, përfaqësuar nga z. Fabian Topollari, të cilët kanë kërkuar kundërshtimin e vendimit nr. 260, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 07, bashkia Pukë, si dhe ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të këshillit bashkiak Pukë, sipas rezultatit të saktë të pretenduar nga ata sepse kanë ndodhur

shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë, që ka ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore.

3. Kërkesat ankimore nr. 63 dhe nr. 70, të paraqitura në KQZ më datë 22.05.2023 iu paraqitën KAS-it, i cili në seancë paraprake vendosi pranimin e tyre për shqyrtim bashkërisht, me vendimin e ndërmjetëm nr. 131, datë 23.05.2023, me relator z. Elvis Çefa. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 24.05.2023, ora 12:30. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, si dhe përfaqësuesit e palëve ankimuese z. Petrit Dedaj dhe z. Fabian Topollari.
  
4. Përfaqësuesi në seancë i subjektit zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, z. Petrit Dedaj pretendoi se ka identifikuar problematika në lidhje me numërimin e votave në KZAZ nr. 7, Pukë. Z. Dedaj cilësoi përpara KAS orën e saktë në pamjet filmike për pesë qendrat e votimit, gjatë numërimit të votave, ku ai ka konstatuar raste të tjetërsimit të fletëve të votimit apo pasqyrime të pasakta të rezultateve në tabelat përmbledhëse. Konkretisht ai demonstroi në seancë pamjet filmike në QV-në nr. 0425, kur vota të vlefshme në favor të subjektit zgjedhor “Partia Republikane” janë shpërndarë për subjektet e tjera zgjedhore, si dhe konstatimin se në këtë kuti votimi ishin 33 vota të pavlefshme nga skanimi i kryer, ndryshe nga Tabela Përmbledhëse e Rezultateve në të cilën janë pasqyruar 32 vota të pavlefshme. Përsa i përket QV 0415/00, ankimuesi u shpreh se gjatë kqyrjes së provave (material video), ka konstatuar 10 fletë votimi të pavlefshme, ndërsa Grupi i Numërimit të Votave ka konsideruar vetëm 3 prej tyre të pavlefshme. Në QV-në nr. 0415/01, po sipas ankimuesit, janë shënuar në procesverbal 21 vota të pavlefshme, por gjatë numërimit të tij nga provat (pamjet filmike) ka konstatuar 23 vota të pavlefshme. Për QV nr. 0422/00, z. Dedaj shprehet se janë 8 vota të pavlefshme, një më shumë se sa është shpallur në Tabelën e Rezultateve për Qendrën e Votimit për këshillin bashkiak, Pukë. Të njëjtën problematikë ka konstatuar për QV-në nr. 0430/00, për të cilën pretendoi se janë 9 vota të pavlefshme, ndryshe nga rezultati që Tabela Përmbledhëse me 8 vota të pavlefshme. Gjithashtu ankimuesi pretendoi se, sipas vëzhguesve

që subjekti zgjedhor në fjalë ka caktuar në ambientet e numërimit të votave, 4 fletë votimi për këshill bashkiak janë hedhur gabimisht në kutinë e votimit për kryetar bashkie. Pala ankimuese pretendoi se për shkak të këtyre parregullsive, subjektit zgjedhor në fjalë, i është hequr e drejta e pasjes së një mandati për këshill bashkiak. Përfundimisht, duke pretenduar se pasqyrimi i saktë i votave të kutive të votimit të sipërcituara, do të sillte ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit dhe si rrjedhojë, edhe marrjen e një mandate për këshillin bashkiak nga “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, ankimuesi kërkoi nga KAS, rivlerësimin e këtyre votave të pavlefshme, duke e konsideruar si shkelje të rëndë të procesit zgjedhor.

5. Përfaqësuesi në seancë i subjektit zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”, z. Fabian Topollari ripohoi pretendimet e palës ankimuese “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, dhe iu bashkua kërkesës të bërë nga subjekti tjetër zgjedhor, që KAS të kontrollojë votat e hedhura në kutitë e votimit të QV-ve, ku palët ankimuese kanë gjetur dhe kanë konstatuar problematika, si dhe përfshirjen e rezultatit të këtyre kutive në tabelën përmbledhëse të rezultatit për KZAZ nr. 07, bashkia Pukë. Z. Topollari ngriti pretendimin se edhe ky subjekt zgjedhor ka humbur një mandat për këshillin bashkiak në bashkinë Pukë, duke pasur diferencë të vogël në numër votash me parti të tjera.

6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesat ankimore nr. 63 dhe nr. 70, datë 22.05.2023;
- Vendimin nr. 260, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 7, bashkia Pukë “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit bashkiak të bashkisë Pukë”;
- Librin e Protokollit;
- Pamjet filmike të tavolinave të numërimit për të gjitha GNV për këshill bashkiak në KZAZ nr. 07, Pukë (material hard-disk) ;
- Kutitë e votimit të QV nr. 0425/00, 0415/00, 0415/01, 0422/00, 0430/00, të KZAZ nr. 7, bashkia Pukë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

#### **KAS-i konstaton:**

1. Provat e administruara nga palët ankimuese nëpërmjet pamjeve filmike përbëjnë indicie të mjaftueshme për KAS për të bërë kqyrjen e fletëve të votimit të ndodhura në 5 kutitë e votimit për këshillin e bashkisë Pukë, në kuptim të pikës 1 të nenit 138 të Kodit Zgjedhor, përkatësisht për qendrat e votimit: nr. 0425/00, 0415/00, 0415/01, 0422/00, 0430/00, të KZAZ nr. 7, bashkia Pukë.
2. Me vendim të ndërmjetëm të KAS, hapja e kutive të sipërcituara u zhvillua në seancë publike në sallën e seancave të KAS, në prani të palëve ankimuese, konform parashikimeve të pikës 2 të nenit 138 të Kodit Zgjedhor. Nga verifikimi i fletëve të votimit për secilën kuti rezultoi sa më poshtë:
  - Në kutinë e QV nr. 0425/00 rezultoi se 64 vota ishin pasqyruar gabimisht në favor të subjektit PDIU, kur në fakt ato vota ishin për subjektin PR. Përsa i përket votave të pavlefshme, numri i votave të pavlefshme nuk ndryshon.
  - Në kutinë e QV nr. 0415/00 rezultoi se 4 vota të pavlefshme ishin llogaritur gabimisht në favor të subjektit FRD. Për subjektin PSD nga 83 vota të pasqyruara, në realitet rezultuan 82. Për subjektin PD, nga 3 vota të pasqyruara rezultuan në fakt 2 vota. Për subjektin PADSH nga 51 vota të pasqyruara rezultuan në fakt se ka 52 vota.
  - Në kutinë e QV nr. 0415/01 rezultoi se nga 21 vota të pavlefshme të paqyruara, në fakt numri i tyre real është 22, ku një votë e pavlefshme ishte llogaritur në favor të subjektit PSD, të cilit i duhet zbritur dhe përfundimisht në favor të këtij subjekti mbeten 118 vota.
  - Në kutinë e QV nr. 0422/00 rezultoi se nuk kishte ndryshime në numërimin e fletëve të votimit.

- Në kutinë e QV nr. 0430/00 rezultoi se 15 vota ishin llogaritur gabimisht në favor të subjekti PSD, në realitet rezultuan 14 të tillë. Për subjektin PD, nga 70 vota të pasqyruara rezultuan në fakt 71 vota.
- 3. Parregullsitë e mësipërme konfirmojnë pjesërisht pretendimet e ankuesit “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” dhe si të tilla, janë të mjaftueshme që KAS të pranojë ankimin e këtij subjekti për këtë pikë duke ndryshuar tabelën përmbledhëse të rezultatit KZAZ nr. 07, bashkia Pukë dhe duke pasqyruar në të rezultatin e këtyre kutive.
- 4. KAS vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e bërë në seancë nga pala ankimuese z. Petrit Dedaj për hapjen e 15 kutive të tjera të votimit për këshill bashkiak, Pukë, të cilat përbëjnë edhe të gjitha kutitë e votimit për këshillin bashkiak, në KZAZ nr. 07, Pukë, për arsye se kërkuesi nuk paraqiti përpara KAS asnjë provë apo indicie të cilat të mund të krijojnë dyshimin e arsyeshëm që në këto kuti ka parregullsi të karakterit të tjetërsimit të votës.
- 5. Në këto kushte, KAS vlerëson se duhet të pranojë pjesërisht ankimin e subjektit zgjedhor “Aleanca Progresiste L.Zh.K. dhe “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 21 , pika 1, shkronja “c” dhe 143, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesave ankimore nr. 63 dhe nr. 70, datë 22.05.2023, të depozituara nga subjektet zgjedhore “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” dhe “Aleanca Progresiste LZHK”.

2. Korrigjimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për këshillin bashkiak, KZAZ nr. 7, bashkia Pukë, sipas gjetjeve të konstatuara nga KAS, sipas tabelës bashkëlidhur vendimit.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më 24.05.2023.

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q
1																	
2																	
3			<b>QARKU SHKODËR</b>														
4			<b>KZAZ NR. 7</b>														
5			<b>GN NR. _____</b>														
6			<b>QV NR. 0415/00</b>														
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	
13																	
14																	
15																	
16																	
17																	
18																	
19																	
20																	
21																	
22																	
23																	
24																	
25																	
26																	
27																	
28																	
29																	
30																	
31																	
32																	
33																	
34																	
35																	
36																	
37																	
38																	
39																	
40																	
41																	
42																	
43																	
44																	
45																	
46																	
47																	
48																	
49																	
50																	
51																	
52																	
53																	
54																	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

**QARKU SHKODËR**

**KZAZ NR. 7**

**GN NR. \_\_\_\_\_**

**QV NR. 0415/00**

TABELA E REZULTATEVE PËR QENDRËN E VOTIMIT

Për këshillin e bashkisë Pukë

**SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME**

Nr	Subjektet Zgjedhore	Numri Votave të Vlefshme	
		Me shifër	Me fjalë
1	Bashkë Fitojmë	14	KatërMbëdhjetë
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	18	Tetëmbëdhjetë
3	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	1	Një
4	Partia Republikane Shqiptare	0	Zero
5	Partia Levizja e Legalitetit	2	Dy
6	Partia Demokracia Sociale	79	ShtatëdhjetëNëntë
7	Aleanca Liberale e Djathtë	0	Zero
8	Partia Socialdemokrate	82	TetëdhjetëDy
9	Partia Demokratike	2	Dy
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	0	Zero
11	Fryma e Re Demokratike	3	Tre
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	3	Tre
14	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	52	PesëdhjetëDy
17	Aleanca Arbnore Kombëtare	34	TridhjetëKatër
18	Partia Balli Kombëtar	0	Zero
21	Fronti i Majtë	0	Zero
34	Partia Kristian Demokrate	7	Shtatë
38	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	10	Dhjetë
	<b>Gjithsej vota të vlefshme</b>	<b>307</b>	TreqindShtatë

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023



**QARKU SHKODËR****KZAZ NR. 7****GN NR. \_\_\_\_\_****QV NR. 0415/01**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

**TABELA E REZULTATEVE PËR QENDRËN E VOTIMIT**

Për këshillin e bashkisë Pukë

1	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	<table border="1"><tr><td>gjithsej</td><td>334</td><td>TreqindTridhjetëKatër</td></tr><tr><td>gra</td><td>165</td><td>NjëqindGjashtëdhjetëPesë</td></tr></table>	gjithsej	334	TreqindTridhjetëKatër	gra	165	NjëqindGjashtëdhjetëPesë	
gjithsej	334	TreqindTridhjetëKatër							
gra	165	NjëqindGjashtëdhjetëPesë							
2	Fletë votimi të papërdorura	298	DyqindNëntëdhjetëTetë						
3	Fletë votimi të dëmtuara	2	Dy						
4	Fletë votimi të gjetura në kuti	335	TreqindTridhjetëPesë						
5	Vota të pavlefshme	22	NjëzetDy						
6	Vota të vlefshme	313	TreqindTrembëdhjetë						
7	Fletë votimi të hedhura gabim	0	Zero						

**SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME**

Nr	Subjektet Zgjedhore	Numri Votave të Vlefshme	
		Me shifër	Me fjalë
1	Bashkë Fitojmë	12	Dymbëdhjetë
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	23	NjëzetTre
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	0	Zero
4	Partia Republikane Shqiptare	2	Dy
5	Partia Levizja e Legalitetit	4	Katër
6	Partia Demokracia Sociale	81	TetëdhjetëNjë
7	Aleanca Liberale e Djathtë	4	Katër
8	Partia Socialdemokrate	118	NjëqindTetëmbëdhjetë
9	Partia Demokratike	3	Tre
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	9	Nëntë
11	Fryma e Re Demokratike	1	Një
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	3	Tre
14	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	25	NjëzetPesë
17	Aleanca Arbnore Kombëtare	14	KatërMbëdhjetë
18	Partia Balli Kombëtar	0	Zero
21	Fronti i Majtë	4	Katër
34	Partia Kristian Demokrate	3	Tre
38	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	7	Shtatë
	<b>Gjithsej vota të vlefshme</b>	<b>313</b>	<b>TreqindTrembëdhjetë</b>

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

**QARKU SHKODËR**  
**KZAZ NR. 7**  
**GN NR. \_\_\_\_\_**  
**QV NR. 0422/00**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

TABELA E REZULTATEVE PËR QENDRËN E VOTIMIT

Për këshillin e bashkisë Pukë

1	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej	153	NjëqindPesëdhjetëTre
		gra	80	Tetëdhjetë
2	Fletë votimi të papërdorura		0	Zero
3	Fletë votimi të dëmtuara		0	Zero
4	Fletë votimi të gjetura në kuti		153	NjëqindPesëdhjetëTre
5	Vota të pavlefshme		7	Shtatë
6	Vota të vlefshme		146	NjëqindDyzetëGjashtë
7	Fletë votimi të hedhura gabim		0	Zero

**SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME**

Nr	Subjektet Zgjedhore	Numri Votave të Vlefshme	
		Me shifër	Me fjalë
1	Bashkë Fitojmë	13	Trembëdhjetë
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	10	Dhjetë
3	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	0	Zero
4	Partia Republikane Shqiptare	11	Njëmbëdhjetë
5	Partia Levizja e Legalitetit	0	Zero
6	Partia Demokracia Sociale	2	Dy
7	Aleanca Liberale e Djathtë	0	Zero
8	Partia Socialdemokrate	16	Gjashtëmbëdhjetë
9	Partia Demokratike	68	GjashtëdhjetëTetë
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	2	Dy
11	Fryma e Re Demokratike	1	Një
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	Zero
14	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	12	Dymbëdhjetë
17	Aleanca Arbnore Kombëtare	9	Nëntë
18	Partia Balli Kombëtar	1	Një
21	Fronti i Majtë	0	Zero
34	Partia Kristian Demokrate	0	Zero
38	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	1	Një
	<b>Gjithsej vota të vlefshme</b>	<b>146</b>	<b>NjëqindDyzetëGjashtë</b>

**QARKU SHKODËR****KZAZ NR. 7****GN NR. \_\_\_\_\_****QV NR. 0425/00**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE**TABELA E REZULTATEVE PËR QENDRËN E VOTIMIT**

Për këshillin e bashkisë Pukë

1	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej	396	TreqindNëntëdhjetëGjashtë
		gra	203	DyqindTre
2	Fletë votimi të papërdorura		440	KatërqindDyzetë
3	Fletë votimi të dëmtuara		7	Shtatë
4	Fletë votimi të gjetura në kuti		395	TreqindNëntëdhjetëPesë
5	Vota të pavlefshme		32	TridhjetëDy
6	Vota të vlefshme		363	TreqindGjashtëdhjetëTre
7	Fletë votimi të hedhura gabim		0	Zero

**SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME**

Nr	Subjektet Zgjedhore	Numri Votave të Vlefshme	
		Me shifër	Me fjalë
1	Bashkë Fitojmë	15	Pesëmbëdhjetë
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	23	NjëzetTre
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	4	Katër
4	Partia Republikane Shqiptare	64	GjashtëdhjetëKatër
5	Partia Levizja e Legalitetit	3	Tre
6	Partia Demokracia Sociale	11	Njëmbëdhjetë
7	Aleanca Liberale e Djathtë	20	Njëzet
8	Partia Socialdemokrate	41	DyzetëNjë
9	Partia Demokratike	15	Pesëmbëdhjetë
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	43	DyzetëTre
11	Fryma e Re Demokratike	26	NjëzetGjashtë
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	Zero
14	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	3	Tre
17	Aleanca Arbnore Kombëtare	33	TridhjetëTre
18	Partia Balli Kombëtar	1	Një
21	Fronti i Majtë	8	Tetë
34	Partia Kristian Demokrate	40	Dyzetë
38	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	13	Trembëdhjetë
	<b>Gjithsej vota të vlefshme</b>	<b>363</b>	<b>TreqindGjashtëdhjetëTre</b>

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

**QARKU SHKODËR**  
**KZAZ NR. 7**  
**GN NR. \_\_\_\_\_**  
**QV NR. 0430/00**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

TABELA E REZULTATEVE PËR QENDRËN E VOTIMIT

Për këshillin e bashkisë Pukë

1	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej	191	NjëqindNëntëdhjetëNjë
		gra	97	NëntëdhjetëShtatë
2	Fletë votimi të papërdorura		257	DyqindPesëdhjetëShtatë
3	Fletë votimi të dëmtuara		1	Një
4	Fletë votimi të gjetura në kuti		191	NjëqindNëntëdhjetëNjë
5	Vota të pavlefshme		8	Tetë
6	Vota të vlefshme		183	NjëqindTetëdhjetëTre
7	Fletë votimi të hedhura gabim		0	Zero

**SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME**

Nr	Subjektet Zgjedhore	Numri Votave të Vlefshme	
		Me shifër	Me fjalë
1	Bashkë Fitojmë	6	Gjashtë
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	4	Katër
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	3	Tre
4	Partia Republikane Shqiptare	26	NjëzetGjashtë
5	Partia Levizja e Legalitetit	8	Tetë
6	Partia Demokracia Sociale	3	Tre
7	Aleanca Liberale e Djathtë	5	Pesë
8	Partia Socialdemokrate	14	KatërMbëdhjetë
9	Partia Demokratike	71	ShtatëdhjetëNjë
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	10	Dhjetë
11	Fryma e Re Demokratike	2	Dy
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	2	Dy
14	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	5	Pesë
17	Aleanca Arbnore Kombëtare	12	Dymbëdhjetë
18	Partia Balli Kombëtar	0	Zero
21	Fronti i Majtë	4	Katër
34	Partia Kristian Demokrate	3	Tre
38	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	5	Pesë
	<b>Gjithsej vota të vlefshme</b>	<b>183</b>	<b>NjëqindTetëdhjetëTre</b>